



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:080623  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05757504

**CAP.nr.1231/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores së përmbartimit S.S nga P,,,,, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.S.K nga P,,,,, kundër debitorit të përmbartimit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) - Prishtinë, me objekt përmbartimi kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, Cpc.nr.310/23, të datës 21.06.2023, me datën **29.05.2024**, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**APROVOHET e themeltë** ankesa e kreditores së përmbartimit S.S nga P,,,,, **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, Cpc.nr.310/23, i datës 21.06.2023, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.310/23, të datës 21.06.2023, e ka refuzuar propozimin për lejimin e përmbartimit të kreditores së përmbartimit S.S, të ushtruar në gjykatë me datën 07.06.2023, sipas dokumentit përmbartimor - Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020 si i pa bazuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditorja S.S, përmes të autorizuarit të tij, për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të priset aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, të lejohet përmbartimi dhe të detyrohet debitori që t'ia paguaj kreditores borxhin sipas propozimit me kamatë ligjore prej 8% nga dita e dorëzimit të propozimit për përmbartim deri në pagesën definitive të tij, apo çështjen ta kthejë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

*- Ankesa e kreditorit të përmbartimit është e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja e përmbartimit S.S, me datën 30.03.2023, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit të përmbartimit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) - Prishtinë, ndërsa gjykata e shkallës së parë si organ përmbartues me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.310/23, të datës 21.06.2023, e ka hedhur propozimin për lejimin e përmbartimit të kreditorës, i ushtruar në këtë gjykatë me datë 30.03.2023, sipas dokumentit përmbartues - Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, si i pabazuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas shqyrtimit të propozimit për lejimin e përmbartimit të parashtruar nga kreditorja, ka ardhur në përfundim se dokumenti në bazë të cilit është propozuar që të iniciohet procedura përmbartimore konform nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, ashtu siç është plotësuar dhe ndryshuar, tutje referuar si “Ligji për Procedurën Përmbartimore”, edhe pse përbën titull ekzekutiv - dokument përmbartimor, i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbartim. Në lidhje me këtë, duhet theksuar se neni 27, paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën Përmbartimore, shprehimisht përcakton se: “dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të janë treguar kreditori, debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.” Mbi këtë bazë, është e qartë se në mënyrë që një dokument përmbartimor të jetë i përshtatshëm për përmbartim, duhet që në mënyrë kumulative të plotësoj të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 27, paragrafin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe atë pa asnjë përjashtim. Rrjedhimisht, bazuar në kërkesën ligjore të lartpërmendur, dokumenti përmbartues mbi bazën e të cilit kreditori e ka ushtruar propozimin për lejimin e përmbartimit në rastin konkret është i pa përshtatshëm për përmbartim. Kjo sepse në dispozitivin e vendimit, përkatësisht dokumentit përmbartimor nuk është përcaktuar shuma të cilën debitori i përmbartimit duhet ta përmbushë ndaj kreditorit të përmbartimit por vetëm në mënyrë të përgjithësuar është obliguar punëdhënësi të bëjë pagesën e kompensimit të dy pagave, pa asnjë specifikim të shumave që duhet kompensuar.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkallë thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 i LPK-së lidhur me nenin 36 të LPK-së, dhe 182.2 pika n) e LPK-së, aktvendimi është marrë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e si rezultat i kësaj ka ardhur edhe deri te zbatimi i gabuar i dispozitave ligjore.

Gjykata ankimore gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjen se pretendimet e palës kreditore janë të bazuara për faktin se aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje të dispozitave nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, për faktin se dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyetimin, po ashtu Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me vendosjen sikurse në dispozitiv të aktvendimit, si dhe po ashtu edhe ato arsye që janë dhënë janë të mangëta, të pa qarta me çka rezulton që aktvendimi si i tillë të jetë i pa qëndrueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Gjykata ankimore vëren se Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit ka konstatuar se Vendimi i Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, në bazë të cilit kërkohet lejimi i përmbarimit nuk është i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti nuk përmban shumën e detyrimit, ashtu siç edhe kërkohet me dispozitën e nenit 27 parag.1 të LPP-së. Mirëpo, nga shikimi i shkresave të lëndës për Gjykatën e Apelit rezultoi një gjendje krejt tjetër, sepse kreditori me propozimin për lejimin e përmbarimit ka kërkuar përmbarimin e dokumentit përmbarues Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, si dhe vendimit për Korrigjim e Gabimit të IP-së, të shkallës së I-rë, me numër Nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020, për pagimin e borxhit për dy paga jubilarë në shumë prej 2.050.20 €, të cilat vendime janë të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme, pasi që i mbajte vulat përkatëse. Përkundër faktit se vendimi 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, nuk përmban shumën e detyrimit, i njëjti është korrigjuar me vendimin Nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020, i cili tani ka edhe shumën e detyrimit (përmes listës e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Ndërsa kreditori në propozimin për përmbarim ka përfshirë të dy dokumentet përmbaruese të cekura më lartë, për çka edhe tani për tani arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar, për pa përshtatshmërinë e përmbarimit të vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, nuk qëndrojnë. Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë fare nuk ka arsyetuar faktin vendimtar që ka të bëjë me atë se në propozimin për përmbarim kreditori ka paraqitur dy vendimet e Inspektoratit të Punës, të cilat e plotësojnë njëra tjetrën në kuptim të vlerësimit si dokumente përmbarimore të përshtatshme për përmbarim, në pajtim me dispozitën e nenit 22 dhe 27 të LPP.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t'i ketë parasysh shkeljet e cekura si më lartë dhe që për evitimin e tyre lidhur me çështjen në fjalë, të ndërmerr veprime përkatëse përmes të cilave do ta sqaroj faktin se *dokumentet në të cilat thirret kreditori a janë të përshtatshëm për përmbarim (përfshirë këtu edhe vendimi korrigjues i Inspektoratit të Punës)*, e më pas të vlerësojë edhe njëherë pretendimet e palëve, si dhe të vlerësojë edhe njëherë lejueshmërinë e përmbarimit, ndërsa nëse është nevoja që për sqarimin e këtij fakti të caktojë seancë dëgjimore, në mënyrë që pastaj gjykata duke aplikuar drejtë dispozitat ligjore, të ketë mundësi që të bie një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të nenit 208 dhe 209 pika (d) të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2023:080623  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05757504

**CAP.nr.1231/23, datë 29.05.2024**

**Gjyqtari,  
Arsim Hamzaj**